



Datë: 30.04.2025

Numër protokoli: 2908/2025

A.nr.511/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.511/2025, të datës 20.03.2025, të parashtruar nga ankuesja E. R. B, kundër Njoftimit të datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.511/2025, e datës 20.03.2025 e parashtruar nga ankuesja E.R.B

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, E.R.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 20.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokoli 1849/2025 nën shenjën A.nr.511/2025, Njoftimit të datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 26.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën të datës 20.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftimin e datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.03.2025; Përgjigjen e datës 26.03.2025; Konkursin e datës

05.02.2025; Vendimin e datës 05.02.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimi; Aplikacionin e ankueses të datës 19.02.2025 me dokumentet bashkangjitura; Njoftimin e datës 12.03.2025 të kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak; Formularët e datës 24.03.2025 për vlerësimin e eses; Njoftimin e datës 24.03.2025 për kandidatët që kanë kaluara verifikimin paraprak; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 24.03.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e palejuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Gjakovës, më datë 05.02.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016633, për Grupi i Arkiv-Dokumentacionit, pozita e punës “Zyrtar për Arkiv”, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjakovës, ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.02.2025 deri më 07.03.2025, ndërsa nga shkresat e këndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja, nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës, përmes Njoftimit të datës 12.03.2025 i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se e njëjta nuk plotëson kriteret e përgjithshme të konkursit respektivisht, ndërlidhur me kualifikimin e kërkuara arsimor dhe përvojën e punës e cila nuk është mbështetur me dokumente përkatëse sipas kërkesave në konkurs.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshëm për procedurën e rekrutimit sipas konkursit RN00016633 të datës 05.02.2025, pasi që i kam plotësuar kriteret e nevojshme, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj ndërsa lëndën ta kthejë për vlerësim të serishëm në fazën e verifikimit paraprak.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, sa i përket procedurave të pranimi lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses mori për bazë dispozitat e nenit 27 Paragrafi 4 te Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , i cili përcakton se: “4. E drejta e ankimimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”, si rrjedhojë meqenëse ankuesja konteston procedurën e rekrutimit që ndërlidhet me fazën e verifikimit paraprak, atëherë Kolegji i Këshilli konstaton se mënyra e parashtrimit të ankesës lidhur me procedurat e pranimi në Shërbimin Civil është rregulluar me nenin 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se: “10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, **pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.**”, dhe me nenin 17 Rregullore Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi Në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”.

Kolegji i Këshillit duke marre parasysh provat e lëndes si dhe duke ju referuara dispozitave të cekura si më lartë konstaton se ankuesja ankesën e datës 20.03.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil e ka parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare, gjegjësisht Kolegji konstaton se meqë procedura e ankimit ndaj procedurës së pranimit është parashikuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, atëherë ankesa e parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare është në kundërshtim me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase refuzimi i aplikacionit të ankueses nuk nënkupton shpalljen e rezultateve përfundimtare në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pasi që procedura e rekrutimit në rastin e konkursit ndaj të cilit ankuesja ka parashtruar ankesë ende nuk kishte përfunduar në kuptim të nenit 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht të paktën deri me datë 20.03.2025 sipas përgjigjes së dhënë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, si dhe konstatimit edhe në sistemin online të rekrutimit konkursi.org-gov.net, ndërsa palës nuk i mohohet ankesa pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Bazuar si më sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 20.03.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, është e pa lejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse e njëjta është parashtruar në fazat fillestare të procedurës së rekrutimit gjatë të cilave ligji material nuk e ka përcaktuar të drejtën e ankesës në KPMSHCK.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.511/2025, datë 30/04/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.R.B;
- Komunës së Gjakovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.